

V E N D I M
Nr. 265, datë 3.6.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.199, DATË
22.4.1999 "PËR RITJEN E PAGAVE PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 22.4.1999 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën «f» bëhen këto plotësime:

- Në fillim të paragrafit të parë shtohet emërtimi «Akademik» me pagë mujore 41 800 lekë. Ky emërtim shtohet dhe në klasifikimin «B3» të lidhjes 1 «Renditja e funksioneve sipas klasifikimit».

- Në fund të kësaj shkronje shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: «Në kreun në përqindje, pas emërimit...» Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë II. Drejtor instituti» shtohet emërtimi «Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave» dhe pas emërimit «Kancelar në fakultet» shtohet emërtimi «Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave».

- Në lidhjen II-8 «Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave» dhe në klasifikimin «B5» të lidhjes I «Renditja e funksioneve sipas klasifikimit» emërtimi «Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave» shfuqizohet.

b) Shtohet shkronja «gj» me këtë përmbajtje:

- Në lidhjen II-a, në fund të kreut 2 «Shtesa të tjera» shtohet ky paragraf:

«Drejtoria të drejtorisë së prefekturave në Ministrinë e Pushtetit Lokal, për kushte pune të vështira të krijuara në situatën emergjente prej ardhjes së popullsisë shqiptare nga Kosova, i jepet një shtesë mbi pagë në masën 100 për qind. Shtesë mbi pagën bazë në masën 100 për qind i jepet një juristi dhe një ekonomisti në prefekturën e Kukësit që caktohen për të punuar në të njëjtat kushte të vështira. Kjo shtesë u jepet duke filluar nga data 14.4.1999 deri në normalizimin e situatës.»

2. Në lidhjen I «Renditja e funksioneve sipas klasifikimit» në klasifikimin «B3» dhe në lidhjen II-5 «Niveli i pagave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore» emërtimi "Këshilltar juridik në Gjykatën e Lartë" shfuqizohet.

3. Në lidhjen II «Paga bazë sipas klasave», që i bashkëngjitet këtij vendimi, paga për klasën VIII bëhet 8 560 lekë, dhe në pikën 6, para fjalës...» shfuqizohet» shtohen fjalët... "pika 3».

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.5.1999

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko